- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

### **23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

### **24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

#### **25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontratës;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

---

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

---

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

---

## Shtojca 5.

(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

### **DEKLARATË**

#### **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ..... është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

---

## Shtojca 6.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**SPECIFIKIMET TEKNIKE TE MATERIALEVE QË DO TË PERDOREN PËR ZBATIMIN E KONTRATËS DO TË PASQYROHEN NË SHTOJCËN E PUBLIKUAR BASHKENGJITUR DOKUMENTAVE STANDARTE TE TENDERIT NË SPE.**

**Shtojca 7.***(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT****Shërbimi që kërkohet:**

Nr.	Nr. Analize	Pershkrimi i zerit te punimit	Njesia	Sasia	Çmimi ne Manual (Leke)	Vlera (Leke)
<b>A. OBJEKTI SHKOLLOR .....</b>						
		<b>A1 - PUNIME BOJATISJE DHE SKELERIE</b>				
1	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte (lyerje fasade)	m <sup>2</sup>	15,704.00		
2	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte (lyerje mur rrethues)	m <sup>2</sup>	3,605.00		
3	2.404	Boje hidroplastike (lyerje brenda )	m <sup>2</sup>	96,569.00		
4	2.451	Boje me hidromat, dy duar (lyerje tavane )	m <sup>2</sup>	54,829.00		
5	2.401	Boje vaji mbi siperfaqe metalike	m <sup>2</sup>	854.00		
6	2.431	Skela me tubo per fasade ~ 8 m	m <sup>2</sup>	13,475.00		
7	2.429	Skela me tubo per tavan ~ 8 m	m <sup>2</sup>	400.00		
		<b>A2 - PUNIME SUVATIMI E VESHJE ME PLLAKA</b>				
1	2.358/b	Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm+rrjete+suva	m <sup>2</sup>	92.00		
2	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8 m	m <sup>2</sup>	636.00		
3	2.328	Patinim muri allçi (stuko)	m <sup>2</sup>	2,143.00		
4	2.330	Patinim tavani allçi (stuko)	m <sup>2</sup>	1,062.00		
		<b>A3 - PUNIME TE NDRYSHME E PRISHJE</b>				
1	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m <sup>3</sup>	7.00		
		<b>SHUMA A=A1+A2+A3</b>				
		<b>Vlera 20% e TVSH</b>				
		<b>VLERA ME TVSH</b>				

---

**Afatet e ekzekutimit:** Kohëzgjatja e Marreveshjes Kuader do të jetë **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e nënshkrimit të saj.

## **Shtojca 8.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

### **FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

#### **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:**

Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike ka në administrim të gjitha objektet parashkollore, shkollore, objektet publike dhe banesat sociale në pronësi të Bashkinë Tiranë, të cilat kryejnë funksionet e tyre gjate gjithë periudhes vjetore me perjashtim te objekteve shkollore ne periudhen Qershor deri ne Shtator, që nderpresin mesimdhenien. Gjëndja teknike e objekteve ne lidhje me cilesine e bojatisjes se mureve te brendeshme e te jashtme eshte monitoruar nga Drejtoria Teknike dhe e Transportit, duke hartuar edhe nje plan veprimi vjetor per mirëmbajtjen e tyre, pra nje planifikim per lyerjen e siperfaqeve te ketyre objekteve sipas nevojave. Grupi i punës për argumentimin e fondit limit, duke u bazuar në nevojat vjetore për ofrimin e shërbimit të lyerjes, referuar planit vjetor të hartuar, ka përzgjedhur disa objekte shkollore për këtë qëllim, referuar sasive të sipërfaqeve të mureve të brendëshme apo të jashtme dhe duke ju referuar cmimeve per njesi te perzgjedhura ne manualin teknik te cmimeve te ndertimit, ka pergatitur materialin e nevojshem ku do te mbeshtetet procedura e prokurimit.

**Qëllimi i Shërbimit:** Ky shërbim ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shtresave të mureve të brendëshme dhe të jashtme të objekteve shkollore duke kryer punime me karakter bojatisje, për higjenizimin, pastrimin dhe ripërtëritjen e ngjyrave në sipërfaqet e mureve të brendëshme dhe të jashtëme të këtyre objekteve.

**Objekti i Shërbimit:** Të mundësojë lyerjen me cilësi dhe në kohë, duke përdorur bojra e materiale ekologjike dhe të standartizuara, në objektet shkollore te Bashkisë Tiranë sipas listës në vijim, të sipërfaqeve te mureve të brendëshëm e të jashtëm dhe tavanet, sipas listës së objekteve të sipërcituar.

**Kontrata zbatohet** me plane të programuara javore, urdhëra pune dhe proces verbale konstatimi, duke mbajtur kontakte të përditshme me përfaqësues të AK të ngarkuar për ndjekjen e procedurës së zbatimit të kontratës, procedurë me të cilin OE njihet zyrtarisht nga AK me fillimin e zbatimit.

#### **Vendi i kryerjes së shërbimeve:**

Vendodhjet e objekteve arsimore në të cilat do të kryhen punimet e kërkuara sipas preventivit, gjenden brenda territorit të Bashkisë së Tiranës. Këto objekte shkollore, sipas tabelës së mëposhtme, janë parashikuar për kryerjen e shërbimit sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventiv. Ndërhyrja në to do të realizohet sipas planit të ekzekutimit të shërbimeve të miratuar nga autoritetit kontraktor.

**Objektet shkollore ku do të kryhet shërbimi:**

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Emertimi i Objektivit</b>	<b>Adresa</b>	<b>Lloji i shërbimit</b>
01	Shkolla 9 vjecare “Ali Demi”	Njesia Adm.Nr. 1	Lyerje ambiente brenda, fasade dhe mur rrethues
02	Shkolla 9 vjecare “1 Maji”	Njesia Adm.Nr. 1	Lyerje ambiente brenda
03	Shkolla fillore “Androkli Kostallari”	Njesia Adm.Nr. 1	Lyerje ambiente brenda
04	Shkolla 9 vjecare “Fan Noli”	Njesia Adm.Nr. 2	Lyerje ambiente brenda, fasade dhe mur rrethues
05	Shkolla 9 vjecare “Mihal Grameno”	Njesia Adm.Nr. 2	Lyerje ambiente brenda
06	Shkolla 9 vjecare “Hasan Tasim”	Njesia Adm.Nr. 2	Lyerje ambiente brenda, fasade dhe mur rrethues
07	Shkolla Speciale “Koreografike”	Njesia Adm.Nr. 2	Lyerje ambiente brenda
08	Shkolla 9 vjecare “Hasan Prishtina”	Njesia Adm.Nr. 3	Lyerje ambiente brenda, fasade dhe mur rrethues
09	Shkolla e mesme “Andon Zako Cajupi”	Njesia Adm.Nr. 3	Lyerje ambiente brenda
10	Shkolla 9 vjecare “Kongresi i Lushnjes”	Njesia Adm.Nr. 3	Lyerje ambiente brenda, fasade dhe mur rrethues
11	Shkolla 9 vjecare “Niket Dardan”	Njesia Adm.Nr. 3	Lyerje ambiente brenda
12	Shkolla 9 vjecare “Bajram Curri”	Njesia Adm.Nr. 4	Lyerje ambiente brenda
13	Shkolla 9 vjecare “Deshmoret e Lirise”	Njesia Adm.Nr. 5	Lyerje fasade dhe mur rrethues
14	Shkolla 9 vjecare “Sabaudin Gabrani”	Njesia Adm.Nr. 7	Lyerje fasade dhe mur rrethues

15	Shkolla 9 vjecare “Drita Pelinku”	Njesia Adm.Nr. 7	Lyerje ambiente brenda
16	Shkolla e mesme “Partizani”	Njesia Adm.Nr. 8	Lyerje ambiente brenda
17	Shkolla 9 vjecare “Misto Mame”	Njesia Adm.Nr. 8	Lyerje ambiente brenda
18	Shkolla 9 vjecare “Lidhja e Prizrenit”	Njesia Adm.Nr. 9	Lyerje ambiente brenda
19	Shkolla 9 vjecare “Qazim Turdiu”	Njesia Adm.Nr.9	Lyerje ambiente brenda
20	Shkolla e mesme “Qemal Stafa”	Njesia Adm.Nr. 10	Lyerje ambiente brenda
21	Shkolla e mbremjes “Kostandin Kristoforidhi”	Njesia Adm.Nr. 10	Lyerje ambiente brenda, fasade dhe mur rrethues
22	Shkolla 9 vjecare “Aleks Buda”	Njesia Adm.Nr. 11	Lyerje ambiente brenda, fasade dhe mur rrethues
23	Shkolla 9 vjecare “Isa Boletini”	Njesia Adm.Nr. 11	Lyerje ambiente brenda

### **Detyrat që duhet të zbatohen:**

Të realizojë në kohë, sasi e me cilësi shërbimet e planifikuara, të cilat do të kryhen cdo ditë pune, duke u kujdesur për të mos penguar kryerjen e aktivitetit shkollor kryerjen e procesit të lyerjes së mureve të brendshme e të jashteme, tavanet e objekteve shkollore dhe riparimet sipas nevojave reale, të përshkruara më poshtë:

### **Përshkrimi i shërbimit:**

#### **1) Lyerje me Boje hidroplastike cilësi e larte, lyerje fasade dhe mure rrethuese**

Lyerja me boje hidroplastike importi do të bëhet për disa objekte shkollore në fasaden e jashteme të këtyre institucioneve si dhe muret rrethuese të tyre. Lyerja do të kryhet me dy duar, pasi të jetë pastruar mirë sipërfaqja e murit dhe pasi të jetë aplikuar astari mbrojtës. Pigmenti i bojës do të përcaktohet në moment sipas dëshirës së autoritetit kontraktor.

#### **2) Lyerje me Boje hidroplastike për sipërfaqe të brendshme të mureve**

Lyerja me boje hidroplastike do të bëhet për sipërfaqet e brendshme të objektit të institucioneve shkollore që kanë të bëjnë me muret e brendshme të tyre. Lyerja do të kryhet me dy duar, pasi të jetë pastruar mirë sipërfaqja e murit. Pigmenti i bojës do të përcaktohet në momentin e aplikimit, sipas dëshirës së autoritetit kontraktor.

#### **3) Lyerje me Boje hidromat dy duar, për lyerje tavanet e ambienteve të brendshme**

---

Lyerja me boje hidromat do te behet per siperfaqet e tavaneve te institucioneve shkollore. Lyrja do te kryhet me dy duar, pasi te jete pastruar mire siperfaqja e tavanit. Lyerja do te behet me boje, pa pigment, me perjashtim te ndonje rasti te vecante.

#### **4) Lyerje me Boje vaji mbi siperfaqe metalike**

Lyerja me boje vaji ne siperfaqe metalike, do te kryhet ne disa objekte shkollore dhe ka te beje me lysterjen me dy duar te siperfaqes se kangjellave ne murin rrethues te objektit si dhe te portes kryesore hyrese per ne oborr.

#### **5) Patinim i mureve dhe tavaneve me allçi (stuko patinimi)**

Patinimi i murit te demtuar nga lageshtira do te behet pasi te pastrohet nga shtresa e demtuar e patinimit ekzistues. Patinimi i tavanit te demtuar nga lageshtira do te behet pasi te pastrohet nga shtresa e demtuar e patinimit ekzistues.

#### **6) Suva e zakonshme fasade per mur tulle dri ne lartesi h ~ 8 m**

Suvatimi ne fasaden e jashteme do te behet ne ato objekte shkollore, ne vendet ku eshte prishur shtresa e suvatimi ekzistues te fasades nga lageshtira, ne zonen prane themeleve ose prane shkarkimit te ujrave prane ulluqeve.

#### **7) Veshje fasade me polisterol kompakt $t=5\text{cm}+rrjete+suva$**

Veshja e fasades me polisterol dhe shtresat perkatese do te kryhet ne disa objekte shkollore, ne fasaden e tyre, qe e kane kete shtrese te demtuar.

#### **8) Skela me tubo per fasade me lartesi mbi ~ 8 m**

Vendosja e skelave metalike do te kryhet ne ato objekte shkollore qe do te lyhen apo riparohen ne fasade gjate gjithë perimetrit te jashtem te objektit shkollore. Montimi i tyre do të realizohet duke respektuar rregullat e sigurimit teknik.

#### **9) Skela me tubo per tavan me lartesi ~ 8 m**

Vendosja e skelave metalike ne ambiente te brendeshme do te behet ne ato objekte shkollore qe lartesia e ambientit i kalon 4 m<sup>2</sup> si dhe ne kafazet e shkalleve.

#### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Të gjitha materialet ndertimore që do të përdoren për kryerjen e punimeve per kete sherbim, duhet të plotësojnë kushtet teknike KTZ dhe KTP dhe standartet teknike kombëtare ose ndërkombëtare, kjo për çdo produkt të pasqyruar në këtë argumentim. Pra, cilësia për materialet e kërkuara është e detyrueshme për t'u zbatuar nga ofertuesi.

**Afati i Marrëveshjes Kuadër:** Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër do të jetë **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga nënshkrimi i saj.

---

## Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

---

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:**

##### **2.1.1 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e kontratës:**

---

Operatori ekonomik ofertues duhet të zotërojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga institucionet shtetërore kompetente si më poshtë:

- NP - 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale;
- NS - 4 B Punime rifiniturë të muraturës dhe të lidhura me to etj.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë në një vlerë jo më të ulët se dyfishi i vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

***Shënim:** Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik Ofertues duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:**

a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas

---

kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i operatorit ekonomik ofertues), Përgjegjës të Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve, për kryerjen e shërbimeve në objekte, i cili duhet të figurojë në listëpagesën e subjektit për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin të jo më pak se 108 (*njëqind e tete*) punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar;
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar;

**Shënim:** *Kjo kërkesë (2.3.3) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**2.3.4** Operatorët ekonomikë ofertues, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, dhe të figurojnë në listëpagesën e subjektit për periudhën e fundit të deklaruar, dhe në vazhdim, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi,

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

**Shënim:** *Kjo kërkesë (2.3.4) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në*

---

*formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar këte dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesën e subjektit për periudhen e fundit të deklaruar dhe në vazhdim, minimumi:

- 30 (tridhjetë) punonjës bojaxhi
- 5 (pesë) punonjës suvatues
- 3 (tre) punonjës teknik ndërtimi
- 1 (një) punonjës specialist për sisteme të thata
- 1 (një) punonjës për veshje fasade (sistemi kapot)

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/çertifikatë e arsimit profesional) lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

*Shënim: Kjo kërkesë (2.3.5) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar këte dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës i cili të jete i pajisur me çertifikatën e trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" ose ekuivalente dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhen e fundit të deklaruar dhe në vazhdim, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për punonjësën e mësipërm duhet të

---

paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente certifikuese të akredituara/liçensuara.

*Shënim: Kjo kërkesë (2.3.6) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka lëshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 10 (dhjete) punonjës të cilët të jenë pajisur me certifikatën e trajnimit "Për punimet në lartësi/montim skelerie" ose ekuivalente, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier" dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për muajin e fundit dhe në vazhdim. Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente certifikuese të akredituara/ liçensuara.

*Shënim: Kjo kërkesë (2.3.7) përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka lëshuar kete dokument. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**2.3.8** Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese për te gjithë materialet te cilat do te perdoren per zbatimin e kontates te cilat jane te pasqyruara ne Shtojcen 6 Formular i Specifikimeve teknike (publikuar ne SPE), katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve lëshuara/publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë ose skedat teknike të lëshuara/publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse materialet të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

**2.3.9** Me qëllim vërtetimit e përmbushjes se standarteve teknike të kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Deklaratë/Çertifikatë Konfirmimiti CE ose Ecolabel ose raportet e testimi të lëshuara nga ente certifikues të akredituar për materialet të cilat do të përdoren në shërbimet e mirëmbajtjes të parashikuara sipas preventivit të publikuar, për të cilët

janë kërkuar standarte teknike kombëtare apo ndërkombëtare të miratuara, të specifikuara në Shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve Teknike (publikuar në SPE), me qëllim vërtetimin e përmbushjes standarteve teknike të kërkuara.

### 2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- c) Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë certifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

**2.3.11** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane”, sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/I N. 25.

**2.3.12** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion për posedimin e mjeteve/ pajisjeve teknike dhe mbrojtëse në pronësi ose me qira, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, minimumi për mjetet/ pajisjet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë;

Nr.	Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia	Gjendja
